

**NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E**  
**ASAMBLESË SË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË**  
**WVP – NDËRMJETËSIM NË SIGURIME SH.A.**

Të nderuar aksionerë,

Me anë të këtij njoftimi dëshiroj t’ju bëj me dije se në datën 13 Maj 2022 ora 16:00 në zyrën e WVP në adresën: Rruga Barrikadave, Ndërtesa 18 H 6 Ap. 11, Tiranë, Shqipëri do të zhvillohet Mbledhja e Asamblesë së aksionarëve të shoqërisë WVP – Ndërmjetësim në Sigurime SHA!

Në rend të ditës së mbledhjes së asamblesë së aksionerëve janë për diskutim dhe vendimmarrje çështjet e mëposhtme:

- 1. Miratimin e riemërimeve të anëtarëve të Këshillit të Administrimit të WVP ndërmjetësim në sigurime SH.A.**
- 2. Të ndryshme**

Në lidhje me pikën e dytë lutemi që nëse aksionerët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë mendojnë se ka diçka për të diskutuar, të paraqesin mendimin e tyre në adresë të administratorit (kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike) si dhe dokumentacionin përkatës që mendon se është i nevojshëm tu shpërndahet aksionerëve paraprakisht, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes.

Ju sjell në vëmendje se për të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së aksionerëve, aksionerët duhet të paraqiten në ditën dhe orën e përcaktuar më sipër, në selinë e shoqërisë, sipas adresës së përcaktuar më sipër. Aksionerët mund të paraqiten dhe të

marrin pjesë personalisht apo nëpërmjet perfaqësuesve të autorizuar. Si perfaqësues i aksionerit mund të jetë një aksioner tjetër apo një person i tretë. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si perfaqësues të aksionerëve në asamblenë e përgjithshme.

Njoftimin e mbledhjes dhe dokumentacionin përkatës (nëse ka) mund ta gjeni edhe në faqen web të shoqërisë në adresën në internet [www.wvp.al](http://www.wvp.al)

Zotërimi i aksioneve aktualisht në shoqëri është si vijon:

- “WVP”, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin austriak, me nr. të regjistrimit tregtar FN 48957x, me seli në Hans-Resel Gasse 19, 8020, Grac, Austri, zotëron [90%] ([nëntëdhjetë përqind]) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, ose 9900 aksione.
- Z. Ali Lena zotëron [5,5%] ([pesë presje pesë përqind]) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, ose 605 aksione.
- Z. Kujtim Ibraimi zotëron [4%] ([katër përqind]) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, ose 440 aksione.
- Z. Petar Andreevski zotëron [0,5%] ([zero presje pesë përqind]) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë ose 55 aksione.

Numri i votave në asamblenë e aksionerëve, që ka secili aksioner është i barabartë me numrin e aksioneve që zotëron secili prej tyre.

Për sa më sipër, lutemi që çdo kërkesë të paraqitet në adresë të perfaqësuesit ligjor të shoqërisë z. Ardian Kelmendi, në selinë e shoqërisë.

Lutemi konfirmoni marrjen e njoftimit për zhvillimin e mbledhjes së asamblesë.

**Administratori**

**Ardian Kelmendi**

